



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 283, DATË 1.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E TIPAVE, RREGULLAVE, KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE PËR PRODHIMIN, RUAJTJEN DHE PËRPUNIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE BLEGTORALE, NË TOKË BUJQËSORE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11/1, pikat 5/2 e 5/4, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës", të ndryshuar, dhe të nenit 8, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 283, datë 1.4.2015 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4, e nënkreut II.a, ndryshohet si më poshtë:

*"4. Për qëllim të llogaritjes së vëllimit/sipërfaqes së ndërtimit, në intensitetin e ndërtimit përfshihet ngastra ose bllok ngastrash edhe kur ndahen nga rrugë, kanale apo kufij të tjerë natyralë, në pronësi apo përdorim. Leje ndërtimi shtesë për të njëjtën parcel/ngastër miratohet vetëm nëse nuk është shteruar intesiteti sipas Planit të Përgjithshëm Vendor ose Planit të Detajuar Vendor. Në njësitë e vetëqeverisjes vendore që nuk kanë Planit të Përgjithshëm Vendor, leje ndërtimi për të njëjtën pasuri mund të nxirret vetëm pas miratimit të PPV."*

2. Në nënkreun II.b bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a. në shkronjën "a" të pikës 1, vëllimi "0.03 m<sup>3</sup>/m<sup>2</sup>" zëvendësohet me vëllimin "3 m<sup>3</sup>/m<sup>2</sup>";

- b. shkronja “b”, e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:  
“b) Të zhvillohen në një kat të vetëm dhe të respektojnë lartësinë maksimale 5.5 metër në ulluk dhe lartësi maksimale 12 metër në kulm, me përjashtim të oxhakëve, siloseve dhe strukturave që tejkalojnë këtë lartësi për shkak të karakteristikave teknike.”
- c. pika 3 ndryshon si vijon:  
“3. Stallat, pavarësisht numërit të krerëve të parashikuar për mbarështim, duhet të plotësojnë këto kritere:
- a. Të respektojnë distancat minimale të mëposhtme:
    - i. 20 metër nga kufijtë e pronës;
    - ii. 300 metër nga zonat e banuara;
    - iii. 50 metër nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane.
  - b. Të zhvillohen në një kat të vetëm, me lartësi të ndryshme në bazë të karakteristikave të veçanta teknike dhe lartësi maksimale 5 m në ulluk dhe jo më shumë se 12 metër në kulm;
  - c. Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej  $4\text{m}^3/\text{m}^2$ .”
- ç. Në pikën 7 përqindja “70%” zëvendësohet me përqindjen “90%”.
- d. Në shkronjën “a” të pikës 10 vëllimi “ $1\text{ m}^3/\text{m}^2$ ” zëvendësohet me vëllimin “ $4\text{ m}^3/\text{m}^2$ ”.
- dh. Shkronja “b” e pikës 10 ndryshon si më poshtë:  
“b) Të respektojnë distancat minimale prej 4 metër nga kufijtë e pronës dhe distancat nga ndërtimet e tjera pa cënuar funksionalitetin e tyre.”
- e. Në shkronjën “a”, të pikës 11, vëllimi “ $1\text{ m}^3/\text{m}^2$ ” zëvendësohet me vëllimin “ $4\text{ m}^3/\text{m}^2$ ”.
3. Shkronja “b”, e pikës 3, të kreut III, ndryshon si më poshtë:  
“b) leja e ndërtimit, në rastet e njësisë të vetëqeverisjes vendore që kanë plane rregulluese të miratuara, lëshohet pas verifikimit të përputhshmërisë me planin rregullues. Në rastet kur njësi e vetëqeverisjes vendore nuk ka plan rregullues të miratuar, leja lëshohet pas kontrollit të përputhshmërisë së projekt-propozimit nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, dhe vlerësimit nga ministria përgjegjëse për bujqësinë për përpërputhshmërinë e tipologjisë së objekteve sipas Kreut I të këtij vendimi”.
4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Edi Rama**